



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më: 22.7.2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit, Fadil Demaku, Qerim Bajrami, Zafir Berisha, Rexhep Selimi, Nuredin Ibishi, Ganimete Musliu dhe Bojan Mitiq anëtar.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Zarife Aliu.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati- Zyra e Presidencës së Kosovës, Naim Hajdari- EULEX, Nehat Dervishi- OSCE, Luanda Domi- DCAF dhe Arbanë Pireva, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi- Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 10.07.2015;
3. Raportimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhuni;
4. Realizimi i planit të punës së Komisionit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 10.07.2015;

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhuni;

Kryetari i Komisionit- Arsyeja e këtij takimi me z. Shpend Maxhuni, Drejtor i Policisë, është pikërisht për shkak të ngjarjeve të fundit ku janë arrestuar disa persona në afërsi të liqenit të Badofcit, natyrisht si Komision për Siguri i kemi marr shumë serioze këto arrestime, nëse do mundeni të na jepni ndonjë informatë deri aty ku ju nuk i cenoni hetimet për rastin në fjalë, pasi ky rast ka ngjallur panikë tek qytetarët tanë.

Shpend Maxhuni- Shfrytëzoj rastin që përpos çështjes konkrete që e kërkoj kryetari, t'ju informoj shumë shkurt rreth gjendjes së përgjithshme të sigurisë, në bazë të analizës së Policisë së Kosovës natyrisht edhe të akterëve tjerë vendorë apo ndërkombëtarë që kanë përgjegjësi nga aspekti i sigurisë. Gjendja e përgjithshme e sigurisë vlerësohet të jetë e qetë edhe nënkontrollë, Policia e Kosovës vazhdon të përmbushë detyrat, obligimet dhe objektivat e saj në bazën të planit strategjik, çdo aktivitet i yni në kohën e duhur dhe informacionet e duhura është bërë i njohur në opinion dhe ne do të vazhdojmë në këtë çasje të njëjtë në mënyrë që çdoherë dhe me kohë opinionin të jetë i njoftuar për të gjitha shqetësimet që i kemi konsideruar me rëndësi të veçantë në mënyrë që të eliminojmë për aq sa kemi mundësi çdo keq informim për situata që mund të pasojnë. Sa i përket çështjes konkrete që e adresoj kryetari i Komisionit, ne kemi lëshuar komunikata dhe kemi dhënë informacionet e nevojshme, kohëve të fundit vërehet një trend i shtuar i një propagande e cila është e udhëhequr dhe organizuar nga elemente të caktuara me prirje radikale si në vend ashtu edhe jashtë vendit duke përfshirë rajonin por edhe më gjërë, ne duhet të pranojmë që këto tendenca janë një sfidë dhe paraqesin një kërcënim jo vetëm për ne si Kosovë por edhe më gjërë, ekstremizmi radikal, ekstremizmi i dhunshëm dhe elementi terrorist paraqesin kërcënim serioz për tërë globin dhe nga ky këndvështrim institucionet e Republikës së Kosovës me theks të vecant Policia e Kosovës në bashkëpunim shumë të ngushtë me gjithë faktorët tjerë relevant e me theks të veçant me Agjensionin Kosovar të Inteligjencës është duke punuar intenzivisht, fatkeqësisht një numër i qytetarëve tanë që konsiderohen në periudha të ndryshme kohore kanë shkuar në zonat e luftës që janë të njohura në Lindjen e Mesme si Siria dhe Iraku, ai numër konsiderohet të jetë rreth 300 qytetarë, mbi informacionet që ne i kemi, llogaritet se në periudha të ndryshme kohore rreth 300 kosovarë kanë qenë pjesëmarrës në këto lufta, ndërsa aktualisht sipas informacioneve që ne i kemi llogaritet të jenë rreth 100 kosovarë që janë pjesë e konfliktit në Siri dhe Irak, por në rrethana të ndryshme ky numër nuk është raportuar i saktë, është ngatruar shifra e kosovarëve që aktualisht janë në konflikt atje me numrin e përgjithshëm të kosovarëve që kanë qenë në periudha të ndryshme kohore, kjo në fakt e ka dëmtuar edhe imazhin e shtetit tonë, kryesisht në rangimet e shteteve pjesëmarrëse në këto lufta, ky sipas disa analizave Kosova rangohet e katërta, që në fakt nuk është kështu sepse numri 100 është shqetësues por nuk është aq i madh që Kosova të rangohet e katërta në rang-listën e shteteve pjesëmarrëse në luftarat në Siri dhe Irak. Policia e Kosovës ka dhe pranon informacione,

këto informacione i analizon, vlerëson dhe përpunon në bashkëpunim shumë të ngushtë me institucionet kompetente. Sa i përket incidentit në liqenin e Badofcit, ku kemi arrestuar pesë persona të dyshimt, ne paraprakisht kemi pas informacion që mund të ndodhin veprime të caktuara nga të cilat mund të ketë veprime terrorise, me datën 11 korrik 2015, Policia e Kosovës ka pranuar një informacion, në bazë të së cilit ka angazhuar të gjitha njësitë relevante për t'i përgjigjur situatës dhe diku rreth orës 01:30 pas mesnatës në afërsi të liqenit të Badofcit ka ndaluar pesë persona, ku gjatë kontrollit në automjetin e tyre janë gjetur disa gjera që ne i konsiderojmë që kanë mundur të përdorën për qëllime terroriste. Në këtë rast është përfshirë edhe njësia kundër terrorizmit e cila funksionon në kuadër të Policisë së Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Shtetit është hapur rasti dhe është duhet u trajtuar, tashmë në kemi në masën e arrestit pesë persona. Edhe ky rast është parandaluar falë efikasitetit të një bashkëpunimi shumë të mirë me qytetarët, ne kemi arritur të senzibilizojmë në masë të madhe opinionin për rrezikun që mund të paraqitet nga elementet të kësaj natyre dhe është për të inkurajuar vullneti i qytetarëve në dhënien e informacioneve për Policinë e Kosovës, do të punojmë shumë në këtë drejtim që sa më shumë të avancojmë bashkëpunimin në mes të Policisë së Kosovës dhe të gjitha shtresave të shoqësirë tonë. Policia e Kosovës duke u bazuar edhe në rrethanat e përgjithshme në vendin tonë edhe në rajon por edhe më gjerë, ka në aplikim një mori masash parandaluese në teren, masa të cilat shihen përmes policëve të uniformuar dhe natyrisht atyre që ne i aplikojmë në rrethana të caktuara, këtë e bëjmë me të vetmin qëllim që Kosova të jetë një vend i sigurtë. E them me përgjithësi se ka vend për kujdes por nuk ka vend për shqetësim nga qytetarët e Kosovës, ne jemi gjithmonë të gatshëm të mbrojmë interesat e qytetarëve tonë, që ata të ndihen të qetë dhe të mos ketë vend për panikë.

Fadil Demaku- Sa mund të konsiderojmë që e kemi nën kontroll gjendjen në vend, sa është prezent rreziku nga ekstremizmi në Kosovë, duke pas parasysh këto dy çështje cilat janë vështirësit ligjore. Si është koordinimi në mes të Policisë së Kosovës, Prokurorisë së Shtetit dhe me strukturat tjera të sigurisë siç është Agjensioni Kosovare i Intelgjencës në luftimin dhe parandalimin e ekstremizmit në vend, poashtu Policia e Kosovës a ka kapacitetet e mjaftueshme për të luftuar këtë dukuri që të gjithë ne të ndihemi të sigurtë në forcën e policisë?

Rexhep Selimi- Ju përmendët rangimin e Kosovës, si rangim i padrejt si rangim i katërt duke mos u bazuar në statistika kjo i bie drejtpërdrejt në dëmtimi e imazhit të Kosovës, nëse Kosova nuk është në vendin e katërt, në cilin vend do të duhet të ishte sipas statistikave reale dhe cilat vende janë parash në përfshirjen e qytetarëve të saj në luftrat në Irak dhe Siri. Ju përmendët po ashtu edhe bashkëpunimin e institucionet tjera shtetërore të sigurisë, shpresoj që ju referohet bashkëpunimit tuaj të domosdoshëm me Agjensinë Kosovare të Intelgjencës, shpresoj që ky bashkëpunim të funksionoj gjithmonë mirë, po deklarimet në interes të qytetarëve të përfaqësues politik, në këtë rast nga Ministrit dhe Kryeministri nuk po duket që kanë pasur një diskurs të qartë publikë, është kërkuar shpeshherë nga Ministrit i Punëve të Brendshme të jap vlerësime për këtë situatë, por kjo heshtje e MPB për mua nuk është e justifikueshme, pasi që Ministri duhet t'ju drejtohet qytetarëve.

Për fund më intereson të di nëse Kosova është qerdhe apo target i sulmeve terroriste, nëse ne jemi target atëherë kjo nuk do të duhet të dëmtonte imazhin tonë. Ju falenderoj për punën që Policia e Kosovës është duke e bërë dhe për bashkëpunimin e mirëfillt që e keni me institucionet tjera të sigurisë, ne si Komision do ju përkrahim gjithmonë.

Zafir Berisha- Në momentin e anulimit të koncertit tradicional që është mbajtur në Kosovë për nder të ditës së Pavarësisë së Amerikës, ka qenë një mesazh jo i mirë për Kosovën, a ka pasur Policia ndonjë informacion pasi që pak ditë më vonë pas anulimit të koncertit ka ndodhur edhe arrestimi në liqenin e Badofcit, po të cilin rast ka pasur edhe disa deklaratat të paqarta dhe konfuze që ka krijuar një paqartësi të madhe në opinion, javëve të fundit janë shtuar masat e sigurisë kryesisht në kryeqytet që ne nga prizmi i qytetarit edhe deputetit na lë hapsirë të dyshojmë që diçka nuk është në rregull në vendin tonë, natyrshëm ne duhet të shqetësohemi dhe informohemi. Arrestimi i fundit i disa qytetarëve tanë, ky arrestim a ka qenë meritë e qytetarëve që e kanë lajmëruar rastin apo meritë e Policisë së Kosovës, sipas asaj që ka dalë në opinion dy nga personat e arrestuar kanë qenë edhe më herët të arrestuar nën dyshim që janë pjesëmarrës në luftat në Siri dhe Irak. Kërkoj nga ju që në rastet ky zyrtarët për informim nga Policia e Kosovës dhe nga Ministra e Punëve të Brendshme për rastet e ndijshme, siç janë këto të kësaj natyre të jenë pak më të kujdesshëm se çfarë informata japin në opinion.

Ganimete Musliu- Ju treguat që Kosova rangohet e katërta për nga numri i pjesëmarrësve të qytetarëve të saj në konfliktin në Siri dhe Irak, ky është një rezultat shqetësues por me gjithë atë nuk e bënë edhe më pak shqetësuese edhe numri i pjesëmarrjes të 300 kosovarëve në këto konflikte, ju po ashtu e cekët që keni një bashkëpunim të mirë me qytetarët dhe faktikisht ky bashkëpunim u pa edhe në rastin e Badofcit, por desha të di se sa keni çasje nëpër fshatrat e Kosovës sepse zakonisht nëpër qytete është një prezencë e shtuar e policisë, sa keni ju bashkëpunim me qytetarët që jetojnë në zonat rurale të Kosovës, duke marrë parasysh që janë më larg mediave edhe kontaktit me policinë, për këtë arsyeje gjasat mund të jenë më të mëdha për zhvillimin e kësaj dukurije negative e cila nuk ka qenë as traditë dhe as kulturë e jona.

Qerim Bajrami- Unë si deputet i përkrah të gjitha veprimet e Policisë së Kosovës që janë për zbatimin e ligjit e sidomos për aksionin e fundit tek liqeni i Badofcit. Unë paraqes brengën boshnjakëve të Kosovës, që aksionet e Policisë së Kosovës t'i shtrini edhe në zonat ku jetojnë boshnjakët, Policia e Kosovës ka mbështetje të madhe atje. Përkrah propozimin e znj. Musliu që kontrollat e Policisë të jenë më të shpeshta në zonat rurale. Dëshiroj të shtoj në opinionin e z. Selimi që a jemi qerdhe apo target, unë mendoj që jemi target i sulmeve. Një 21 vjeçar nga Prizreni ka vdekur në këtë konflikt në Siri, a keni marrë ndonjë informatë lidhur me këtë rast?

Bojan Mitic- Dëshiroj t'ju falenderoj për punën që e bëni, pasi kjo punë e bërë nga ju e kthen besimin tek qytetarët. Desha të di se çfarë keni ndërmarrë ndaj 180 sulmeve të pesë muajve të fundit, sulme këto me karakter ndëretnik sidomos në Kishnicë.

Nuredin Ibishi- Si është bashkëpunimi në mes të policisë dhe qytetarëve në zonat rurale, po ashtu si është bashkëpunimi me institucionet e sigurisë siç është Agjensioni Kosovarë i Intelgjencës, EULEX-it dhe KFOR-it në këmbimin e informacioneve, si është bashkëpunimin në këmbimin e informacioneve në nivelin ndërkombëtarë, në cilën fazë të procesit është Kosova në rrugën e integritetit në Interpol, Europol por edhe në organizatat tjera të sigurisë në rajon. Njësitë e specializuara të policisë a kanë nevojë për paisje buxhetore shtesë dhe a janë njësitë e specializuara të policisë të përgaditura për të vepruar kundër terrorizmit?

Anton Quni- Çfarë mendoni ju se duhet të bëjë legjislacioni që Policia e Kosovës të jetë më kompetente, më operacionale, më efektive që të mbajë gjithmonë avantazhin kundrejt formacioneve terroriste?

Shpend Maxhuni- Do filloj me pytjet që i parashtror z. Demaku, unë me përgjegjësi them që Kosova është vend i sigurtë përball çfarëdo tendence që mund të paraqitet nga elementet terroriste, Policia e Kosovës ka në strukturën e saj kapacitetet e nevojshme për luftimin e kësaj dukurie. Bashkëpunimin jonë me institucionet tjera të sigurisë sidomos me Agjensionin Kosovare të Intelgjencës është shumë i ngushtë, por bashkëpunimi jonë është i pa shmangshëm edhe me akterët ndërkombëtar që janë në Kosovë dhe përtej kufijëve.

Z. Selimi, më vjen keq por nuk kam informacione se cilat shtete janë para nesh në rang-listën e shteteve pjesëmarrës në konfliktin në Siri dhe Irak, për shkak se Kosova nuk është anëtare e mekanizmave të sigurisë siç është Interpol dhe Europol neve na mungojnë informacionet për pjesëmarrjen e qytetarëve të shteteve tjera në këtë konflikt. Kosova nuk është qerdhe e terrorizmit por është target, këto trende tek ne janë paraqitur pas përfundimit të luftës, këto trende e kanë fillin me hapjen dhe funksionimin e disa organizatave joqeveritare ndërkombëtare në vendin tonë, ka qenë shumë e vështirë edhe për mekanizmat ndërkombëtar që të përcaktohej se cila ishte qëllimi i tyre që atë periudhë kanë qenë shumë aktive. Nga aspekti i legjislacionit ne e kemi një bazë të mirë legale, tashmë e kemi edhe ligjin për parandalimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në konfliktet e armatosuara, kemi strategjinë nacionale e cila në mënyrë specifike parasheh një mori masash dhe aktivitetet nga të gjitha institucionet që kanë përgjithësi nga aspekti i sigurisë por edhe në aspektin shoqëror dhe aspekti kulturor.

Anulimi i koncertit për nder të Ditës së Pavarësisë së Amerikës, nuk ka qenë kompetencë e Policisë së Kosovës, ne nuk kemi informata se cili ka qenë shkaku i anulimit të këtij koncerti. Policia e Kosovës siç e vlerësuat edhe ju, është duke e bërë një punë efektive por qytetarët i kanë paraprijë punës së Policisë së Kosovës, qytetarët kanë qenë të sensibilizuar dhe të gatshëm të bashkëpunojnë me Policinë e Kosovës. Sa i përket shtimit i masave të sigurisë sidomos në Prishtinë është pikërisht sepse ne së fundi kemi diplomuar një gjeneratë të re të policëve të cilët janë duke e përfunduar trajnimin fushor në Prishtinë për shkak të specifikave që i ka Prishtina dhe mundësisë së tyre për të mësuar më shumë në aspektin profesional, Policia e Kosovës mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës natyrisht ne çdoherë i japim prioritet zonave që janë të identifikuar si zona potenciale ku mund të shkaktohen problemet, shumica e zonave rurale në vendin tonë janë zona të qeta. z. Bajrami vlerësoj që Policia e Kosovës, duhet të zgjeroj aktivitetet e saj edhe në zonat ku jeton komuniteti boshnjak, po e ritheksoj atë që e thash edhe më herët që Policia e Kosovës trajton njejtë të gjithë qytetarët pavarësisht përkatësisë etnike, këtë e kemi dëshmuar në shumë rrethana, ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha komunitetet në Kosovë, duke e përfshirë edhe komunitetin boshnjak, presim informacione për rastin të cilin ju e potencuat, jemi duke e trajtuar këtë informacion i cili është bërë publik ku një qytetarë i Prizrenit ka humbur jetën në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, jemi në bashkëpunim shumë të ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtar.

z.Bojan i referohet aksidenteve ku janë të përfshirë komunitetit serb, një shifër të cilën e theksoj z. Bojan , ku sipas tij kanë ndodhur 180 aksidente me karakter ndëretnik, unë me përgjethësi e them që deri tani asnjë incident nuk është i cilësuar nga institucionet kompetente me karakter ndëretnik, ka incidente ku viktimë janë serbët por edhe aksidente në zona të ndryshme ku viktimë janë shqiptarët, por ka aksidentet ku viktimë janë serbët edhe shqiptarët, vjedhja nuk

është aksident i karakratit ndëretnik apo aksidente të trafikut sepse ka pasur tendencë që këto aksidente të atribohen me karakter ndëretnik. Z. Ibishi, kërkoi që të dinte më shumë rreth bashkëpunimit tonë me AKI-in, EULEX-in dhe KFOR-in, me AKI-in kemi një bashkëpunim shumë të ngushtë poashtu këtë bashkëpunim e kemi me KFOR-in dhe EULEX-in të gjitha informacionet e sigurisë së përgjithshme ndahen me këtë dy faktor, këmbimi i informacioneve në nivle ndërkombëtar të sigurisë siç është Interpoli, Europol dhe iniciativat e ndryshme rajonale, ne si zëvendësim të këtyre mekanizmave vazhdojmë të shfrytëzojmë Drejtorinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit e cila funksionon në kuadër të Policisë së Kosovës, por se ku është Policia e Kosovës në rrugën e integriteteve në këto mekanizma, ne kemi aplikur këtë vit ende nuk kemi marr përgjegjje se cili do të jetë epilogu i kësaj procedure, problemi esencial është që Kosova nuk është pjesë e OKB-së, ne si Polici e Kosovës kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme si nga aspekti legal, teknik dhe human dhe jemi të gatshëm që të jemi pjesë e këtyre mekanizmave kurdo që të mirret vendimi. Në kemi bashkëpunim me Interpolin po ky bashkëpunim është përmes kanaleve ndërkombëtare që janë prezent në Kosovë. Njësia speciale e Policisë së Kosovës është e trajnuar mirë, pajisur mirë por nuk do të thotë që paisjet që janë në dispozicion mund të shërbejnë edhe për një periudhë relativisht të gjatë kohore. Policia e Kosovës funksionon mbi bazën e Kushtetutës, ligjeve, ligjit të policisë, udhëzimeve dhe parimeve që e ndërtojnë funksionimin e Policisë së Kosovës, në anën tjetër ne kemi një grup njerëzish të strukturuar që nuk respektojnë as një normë ndërkombëtare apo vendore ku ata operojnë, kjo i favorizon atë pjesë për të vepruar në formën apo planin që ata e kanë përcaktuar karrshi Policisë së Kosovës, unë ju siguroj që legjislacioni aktual i mundëson Policisë së Kosovës dhe Agjensioneve tjera të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme duke respektuar normat ligjore përdorimi i metodave duke inkorporuar edhe elementin e forcës çdoherë duhet të jetë i vlerësuar në bazën e veprimit që vije, duhet të jetë proporcional me veprimin i cili mund të vije në drejtim të vendit tonë, Policia e Kosovës ka në dispozicion konceptet e veptimit mjaftë të qarta, ka paisjet e nevojshme për t'u ballafaquar ndaj çfarëdo veprimi të mundshëm, tani për tani nuk vlerësojmë që ka nevojë për ndryshim të legjislacionit në qasjen e përgjithshme ndoshta do të ketë hapsirë për disa modifikime sepse me këtë çështje nuk duhet të mirret vetëm Policia e Kosovës po duhet të mirret edhe gjithë shoqëria jonë nëse synojmë që të ruajmë kombin tonë nga krimi dhe aktet me karakter terrorist.

Rexhep Selimi- Sa i përket pyetjes që i bëri z. Bojan dhe statistikave që ju referua, pse Policia e Kosovës nuk i ka ato statistika, nuk e di ku i keni marr ato statistika që kinse janë bërë 180 sulme me motive etnike, sikur të ishin 180 sulme me motive etnike do të ishim në një situatë të jashtëzakonshme dhe do kërkohej kontributi jonë i përbashkët për mos të ndodhur këto.

Kryetari i Komisionit- Ne si deputet të Komisionit për Siguri jemi të gatshëm t'ju përkrahim në çdo formë që ju e vlerësoni Policinë e Kosovës, ju përgëzoj për punën e bërë deri tani z. Maxhuni.

4. Realizimi i planit të punës së Komisionit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015;

Kryetari i Komisionit- Kemi marr plani e punës të paraparë për këtë sesion, nëse e shohim plani në tërësi është një gjashtë mujor i suksesshëm me disa përjashtime të vogla, z.Ibishi nuk e ka

përmbyllur mbikëqyrjen e ligjit për Policinë por që është në proces, sa i përket hartimit dhe miratimit të ligjeve nuk kemi pas asnjë pengesë, janë kaluar të gjitha në forma të rregullta ligjore dhe kohore, kemi pasur mbikëqyrje në teren, vizita në teren, kemi pasur takim me Ministrin e Punëve të Brendshme, Komandanin e FSK-së, ish- Komandantin e FSK-së, Ministrin e FSK-së, shefin e departamentit të zjarrëfiksive, zjarrëfikësit, shefi i Agjensionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe takimi i sotshëm me Drejtorin e Policisë së Kosovës, mendoj që e kemi përmbyllur një gjashtë mujor të suksesshëm të punës, në gjashtë mujorin e ardhshëm do të kemi obligime shtesë kemi disa ligje në pritje siç është ligji për Komisionerit e Kuvendit për FSK-në dhe Policinë, ligji për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ligji për Policinë, jemi në pritje për ligjin për pensionimin e parakohshëm të pjesëtarëve të Policisë, ligji për transformimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës jemi të gatshëm për t'i dhënë përkrahje kudo që të vije pako ligjore, në mbledhjen e fundit të kryesisë është konstatuar që mos të jetë në rendin e ditë të seancës përshkak se nuk ka pasur një marrëveshje paraprake me "Listën Sërspka", përjashtoj komunitetet tjera që i kanë dhënë përkrahje, "Lista Sërspka" nuk ka qenë e gatshme ti japin përkrahjen me arsyetimin se nuk e kanë arritur ta shohin ligjin për Ushtinë e Kosovës. Kemi pasur bashkëpunime me organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovës si: OSBE, DCAF dhe GIZ të cilët i falenderoj për mbështetjen e dhënë.

5. Të ndryshme

Deputetët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së falenderuan DCAF-in për vizitën studimore në Republikën e Kroacisë në datën 6-8 korrik 2015 kjo vizitë ka qenë pjesë e projektit "Qeverisa dhe Llogaridhënia në Sektorin e Sigurisë".

Kryetari i Komisionit ftoi deputetët dhe z. Shpend Maxhuni në një drekë të përbashkët pune në përfundim të takimit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj